



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 43

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.279, datë 8.5.2003	Për një ndryshim në vendimin nr. 518, datë 12.8.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kategorizimin, klasifikimin dhe regjistrimin e njësive akomoduese”.....	1611
Vendim i KM nr.281, datë 8.5.2003	Për një shtesë në vendimin nr.646, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike, të projektimit dhe të zbatimit në fushat e industrisë dhe të energjetikës, të cilat duhet të marrin statusin “Rregulla teknike”, të detyrueshme për zbatim””	1627
Vendim i KM nr.282, datë 8.5.2003	Për hapjen e shkollave pasuniversitare, pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Politeknik.....	1629
Vendim i KM nr.289, datë 24.4.2003	Për kriteret dhe përbërjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime, shtetërore.....	1630
Vendim i KM nr.292, datë 24.4.2003	Për disa shtesa në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar.....	1633
Vendim i KM nr.295, datë 8.5.2003	Për përcaktimin e koeficientit të indeksimit të bazës mesatare të vlerësimit vjetor, individual për llogaritjen	

	fillestare të pensionit.....	1634
Vendim i KM nr.296, datë 8.5.2003	Për disa shtesa në vendimin nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit””.....	1635
Vendim i KM nr.297, datë 8.5.2003	Për miratimin e procedurës së dhënies me koncesion, si propozim i pakërkuar, sipas projektit të shoqërisë “La Petrolifera Italo Rumena” s.p.a, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave bregdetare dhe të infrastrukturës portuale detare në Gjirin e Vlorës.....	1636
Vendim i KM nr.299, datë 8.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.219, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e racës autoktone të buajve nga zhdukja”.....	1637
Vendim i KM nr.302, datë 15.5.2003	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit...	1637
Vendim i KM nr.304, datë 8.5.2003	Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit.....	1640
Vendim i KM nr.306, datë 15.5.2003	Për miratimin e amendamentit nr.1 të kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërive OMV (Albanien) Onshore Exploration GmbH dhe Hellenic Petroleum s.a., për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqet 4 dhe 5 në tokën shqiptare.....	1642
Vendim i KM nr.308, datë 8.5.2003	Për dhënie emri Akademisë së Nënoficerëve.....	1649
Vendim i KM nr.309, datë 15.5.2003	Për trajtimin e punonjësve të administratës së Albkromit sh.a., që shkurtohen nga privatizimi dhe dhënia me koncesion e industrisë së kromit.....	1649
Vendim i KM nr.312, datë 15.5.2003	Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.....	1650
Urdhër i KM nr.54, datë 8.4.2003	Për hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit “Për menaxhimin e sezonit turistik veror 2003”.....	1653
Udhëzim i MF dhe MRRTT	Mbi licencimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike.....	1653

V E N D I M
Nr.279, datë 8.5.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 518, DATË 12.8.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KATEGORIZIMIN, KLASIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E NJËSIVE
AKOMODUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 124 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.518, datë 12.8.1996 të Këshillit të Ministrave guida e kategorizimit dhe e klasifikimit të njësive akomoduese turistike, e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të sipërpërmendur, ndryshon si më poshtë vijon:

“Kapitulli I - Kriteret e klasifikimit dhe vlerësimit të hoteleve me yje dhe kapitulli II - Kriteret e klasifikimit dhe vlerësimit të moteleve me yje, ndryshohen dhe zëvendësohen me kapitujt I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

GUIDË E KATEGORIZIMIT DHE KLASIFIKIMIT TË NJËSIVE AKOMODUESE TURISTIKE

Koncepti i njësisë akomoduese

Njësitë akomoduese janë struktura në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, të cilët vënë në dispozicion të klientëve vendas dhe të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një kohë qëndrimi të papërcaktuar, shërbimet e fjetjes, ushqimit dhe pijes të pranuar si të përshtatshme për veprimtari akomodimi.

Njësitë akomoduese ndahen në turistike dhe joturistike.

Njësitë akomoduese turistike - janë struktura, të cilat vënë në dispozicion të klientëve vendas dhe të huaj shërbimet e fjetjes, të ushqimit dhe të pijes, si dhe lehtësirat e duhura në objekte komode, kushte të mira pritjeje, kompetencë profesionale dhe në përputhje me nivelet e përcaktuara në guidën e kategorizimit dhe klasifikimit të këtyre njësive.

Njësitë akomoduese joturistike – janë struktura, të cilat nuk iu nënshtrohen kategorizimit dhe klasifikimit sipas guidës së kategorizimit dhe klasifikimit të njësive akomoduese turistike.

Njësitë akomoduese turistike ndahen në klasat e mëposhtme:

- A. Hotelenga “një yll” deri në “pesë yje”
- B. Motelenga “një yll” deri në “tre yje”
- C. Fshatra turistike, të cilat mund të kategorizohen në:
 - me vilanga “një yll” deri në “pesë yje”
 - me bungalounga “komode” deri në “luks”
 - shtëpi pushimiga “komode” deri në “cilësi e lartë”
 - kampingjenga deri në me “dy yje”.

I. KRITERET E VLERËSIMIT DHE KLASIFIKIMIT TË HOTELEVE ME YJE

Hoteli - është njësia akomoduese turistike, e cila vë në dispozicion të klientëve shërbimet e fjetjes, të ushqimit, të pijes, si dhe shërbime të tjera plotësuese, në ambiente funksionale të mirëmbajtura dhe të pranuar për veprimtari akomodimi, me minimum 7 (shtatë) dhoma.

Hotelet me veprimtari turistike akomoduese për destinacione të veçanta, si hotele të qendrave kurative, bregdetare, malore, për konferenca ose kongrese etj., duhet të kenë strukturën dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e veprimtarive të tilla.

Moto e akomodimit: “Në hotel klientit i ofrohet dhoma dhe jo krevati”.

Elemente të përgjithshme për vlerësimin dhe klasifikimin e hoteleve

A. Elemente të jashtme

1. Vendndodhja (në qendra të banuara, zona bregdetare, malore, liqenore).
2. Pamja e jashtme arkitektonike, veshja e jashtme e godinës, materiali i përdorur:
 - veshje me mermer, me granit, me alumin, me material të veçantë,
 - veshje me gurë të punuar, me tulla dekorative, me dru ose me gurë natyrorë,
 - materiale të ngjashme,
 - suva plastike, dekorative ose e thjeshtë.
3. Përshtatja arkitektonike me vendndodhjen dhe specifikën akomoduese (ose me destinacionin e veprimtarisë akomoduese).

4. Ambienti rrethues, niveli i higjienës, ndriçimi, dekorimi.

5. Hyrja kryesore e niveluar dhe me gjerësi jo më pak se 6 m.

Strukturat akomoduese duhet të jenë të siguruara me roje 24 orë.

B. Elemente të brendshme

Receptioni

Banaku, bashkëkohor dhe me gjatësi jo më pak se 2 m.

Receptioni ofron:

- shërbimin e pronotimit,
- mënyrën e pagesës,
- informacion për kategoritë, për llojshmërinë dhe çmimet e dhomave,
- mbajtjen e çelësve,
- kasafortë për ruajtjen e sendeve me vlerë, kutinë e ndihmës së shpejtë, - informacion për llojet e shërbimeve të ofruara dhe oraret,
- listën e çmimeve për shërbimet suplementare,
- informacion për taksat eventuale, nëse ka të tilla,
- afishimin e kursit të valutës dhe këmbim valute,
- informacion turistik, të përgjithshëm dhe plotësues mbi vendndodhjen e strukturës, mënyrën e lëvizjes në zonën ku ndodhet, transportit, ndërlidhjes dhe parkimit të automjeteve.

Holli

- sipërfaqe min. 16 m²,
- porta e hyrjes, mundësisht automatike, në përmasa që lejojnë hyrjen e lirshme të klientëve dhe bagazheve të tyre,
- dysheme të shtruara (me pllaka, me mermer, me granit, me dekoracion etj.).
- kënde çlodhjeje të kompletuara në varësi të kapacitetit akomodues,
- tapet ose qilim, zbukurim dhe dekorim me lule, vepra arti etj.,
- tabela të dukshme orientuese për në mjediset e brendshme,
- tualete publike.

Dhomat

- Sipërfaqet minimale (pa përfshirë paradhomën dhe tualetin):

- për një person 10 m²,
- për dy persona 12 m² (matrimoniale),
- për dy persona 14 m² (krevate teke),
- temperatura normale 18 – 20 gradë C,
- me hapësirë të mjaftueshme për qarkullim të lirshëm,
- lartësia e tavanit nga dyshemeja minimumi 260 cm,
- 100 për qind e dhomave të pajisura me banjo,

- me derë të veçantë, të sigurt dhe me mbyllje nga brenda,
- të pajisura me krevate teke gjerësia min. 90 cm, dopio min. 152 cm, distanca nga dysHEMEja jo min. 55 cm dhe midis krevateve teke min. 60 cm,

- komodinë,
- tavolinë ose skrivani,
- tualet me pasqyrë,
- raft për rroba,
- abazhurë,
- karrige ose poltrone,
- mokat, tapet ose shendileta,
- perde të holla dhe të trasha ose grila që nuk depërtojnë dritën,
- priza dhe çelësa elektrikë.

Lejohet ndërtimi i dhomave në nivelin e katit përdhes/të parë, vetëm kur godina ka distancë nga toka disa shkallë dhe lejon ndriçim të mjaftueshëm të dhomës.

Apartamente (suite)

- sipërfaqja min. 40 m²,
- jo më shumë se 3 krevate,
- jo më pak se dy ambiente ose ndarje,
- numri i apartamenteve jo më shumë se 20 për qind të numrit të përgjithshëm të dhomave për hotele me 1-3 yje.

Lejohet përqindje më e lartë për hotelet me 4 - 5 yje dhe fshatrat turistike.

Ballkonet dhe verandat

- të kompletuara me të gjitha pajisjet e përshtatshme dhe të nevojshme, në vartësi të sipërfaqes së tyre, të vendndodhjes dhe të natyrës së strukturës.

Banjat dhe tualetet

- sipërfaqja minimale 2.5 m²,
- temperatura normale e ambientit 21 – 22 gradë C,
- hapja e derës së banjës nga jashtë,
- dysHEMEja dhe muret anësore, në lartësi jo më pak se ½ e lartësisë së mureve, të veshura me mermer, me qeramikë ose me material të ngjashëm, rezistent ndaj acideve dhe solucioneve dhe që pastrohen me lehtësi.

Të pajisura me:

- vaskë me perde ose kabinë dushi,
- lavaman,
- dollap mbi lavaman,
- pasqyrë min. 40 x 50 cm,
- WC,
- mbajtëse peshqiri,
- mbajtëse letre higjienike,
- shampo dhe sapun,
- varëse për rroba,
- kosh për mbeturina,
- ajrosje natyrale ose aspirator,
- rregullator voltazhi,
- prizë me shenjë dalluese voltazhi,

Biankeritë

për dhomat e klientëve: çarçafë, këllëf jastëku, mbulesa krevati, shendileta,

b) banjat e klientëve: peshqirë, mantobanjë, shendileta për banjë,

për restorantin: mbulesa tavoline, sipërmbulesa, molotone,

për dhomat dhe mensat e personelit: peshqir, mbulesa etj.,

uniforma e personelit për kamarierë, sportelistë, punonjës të hollit, hotelit etj., të jenë cilësore, të

bardha ose dekorative, të prodhuara me fibra natyrale dhe të plotësojnë të gjitha kushtet higjieno – sanitare.

Çarçafët dhe peshqirët të ndërrohen:

- për çdo klient të ri,
- për të njëjtin klient 1 x 3 ditë (për hotelet me një yll)
1 x 1/2 ditë (për hotelet me 2-3 yje)
çdo ditë (për hotelet me 4-5 yje).

Korridoret dhe kalimet

- me hapësira të mjaftueshme për kalim dhe qarkullim të lirshëm të punonjësve të hotelit dhe të klientëve, kur janë të shoqëruar me bagazhe,
- me gjerësi jo më pak se 1.5 m dhe të ventiluara,
- të dekoruara dhe të mirëmbajtura sipas një standardi të lartë.

Salla për mbledhje, seminare dhe konferenca për hotelet me pesë yje kapaciteti, minimumi 100 persona,

- izolim akustik perfekt,
- dritare që garantojnë errësim të plotë,
- tavolinat dhe karriget të përshtatshme për llojin e aktivitetit që organizohet,
- sistem elektrik të pavarur,
- çelës kontakti të pavarur,
- ndriçim të mjaftueshëm dhe me komandim, mikrofon, monitor, videoregjistrator, aparat dhe kabinë projektimi, panele të lëvizshme,
- sistem alarmi dhe ndriçues emergjence,
- qendër komunikimi ose kabinë telefonike në dispozicion të pjesëmarrësve,
- garderojë dhe tualete të veçanta për sallat me kapacitet mbi 50 persona,
- personel shërbimi të specializuar,
- dalje të veçanta (exit).

Sekretari e pajisur me tavolinë, me karrige, me kompjuter, me kasafortë, me tel. dhe fax.

Kuzhina

- vendndodhja e saj rekomandohet në të njëjtin kat me restorantin,
- përmasat, në raport me kapacitetin e restorantit, projektuar, ndërtuar dhe shtruar për eliminimin e zhurmave, burimet e tymrave dhe të erërave brenda e jashtë saj,
- e kompletuar me pajisjet për gatim, bashkëkohore dhe standard të lartë,
- vendosja e lavamanëve, lavapjatave dhe pajisjeve të tjera, e konceptuar për të garantuar organizim të mirë brenda hapësirës dhe në kushte higjienike optimale,
- ushqimet dhe pijet të ruhen brenda normativave, standardeve dhe kushteve higjieno – sanitare,
- dezinfektim periodik kundër parazitëve, insekteve etj. me preparate të rekomanduara dhe të kontrolluara nga Instituti i Higjienës.

Restoranti

Sipërfaqja min. e restorantit në raport me kapacitetin akomodues, por jo më pak se:

- 1 m² për person (hotelet me një yll);
- mundësisht i ndarë nga kuzhina me dopio derë për të evituar depërtimin e erërave të kuzhinës në sallë;
- temperatura minimale e ambientit 20 gradë C,
- menu e larmishme,
- complete servisi të cilësisë së lartë,
- shërbim me profesionalizëm.

Personeli i shërbimit

Raporti i numrit të personelit të shërbimit me kapacitetin akomodues:

- 1 person për 5–6 shtretër, për hotele me një yll,
- 1 person për 3–4 shtretër, për hotele me dy dhe tre yje,

- 1 person për 1–2 shtretër, për hotele me katër dhe pesë yje.

Paraqitja e jashtme e personelit duhet të jetë në lartësinë e duhur, me uniformë lehtësisht të identifikueshme nga klientela dhe në përshtatje me shërbimet që ato kryejnë. Për personelin duhet të ketë dhoma për zhveshje ose garderoba, vende ose salla ngrënie dhe tualete të veçanta.

Furnizimi me ujë

- furnizim me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje me presion normal,
- furnizim i garantuar të paktën gjatë dy ditëve nga rezervuarët (në rastet e ndërprerjeve të mundshme të furnizimit me ujë).

Ndriçimi elektrik

- i garantuar në vazhdimësi dhe me tension të mjaftueshëm,
- ndriçimi i hapësirave në përputhje me funksionin e tyre,
- gjeneratorë pa zhurmë dhe kapacitet të mjaftueshëm (në rast ndërprerjeje të energjisë elektrike).

Izolimi elektrik

Instalimet elektrike, kutitë shpërndarëse në mjediset dhe repartet ndihmëse, si kuzhina, banja, lavanteri etj., duhet të jenë të hidroizoluara.

Instalimet në vende të hapura duhet të jenë bërë me materiale të papërshkueshme nga uji ose rezistente ndaj agjentëve atmosferikë. Tokëzimi i pajisjeve elektrike, si dushe, rubineta, frigoriferë, larëse rrobash, larëse pjatash, gjeneratorë etj., është i detyruar.

Masat kundër zjarrit

- sistem alarmi dhe udhëzime për rastet e rënies së zjarrit,
- planin e evakuimit në çdo kat dhe ambiente komune,
- pajisjet e emergjencës për mbrojtjen kundër zjarrit,
- përdorimi i materialeve me koeficient të lartë rezistence kundër zjarrit për ndërtimin dhe arredimin e strukturave.

Sistemi i ventilimit

Ventilim i detyrueshëm në mjediset ndihmëse, mekanik ose natyral, me fuqi aspiruese në përmasa që sigurojnë parandalimin e erërave të huaja për të depërtuar në mjediset e përbashkëta (e vlefshme dhe për ajrin e ndotur të tualeteve në rast lidhjeje me të njëjtin oxhak ventilimi).

Trajtimi dhe magazinimi

- magazina duhet të ketë hapësirë me dimensione të mjaftueshme në varësi të kapacitetit akomodues dhe sallave të shërbimit, derë të sigurt brenda godinës,
- të jetë e kompletuar me raftë dhe pajisje të tjera të nevojshme për ruajtjen në kushte optimale të produkteve, artikujve ushqimorë, pijeve etj.,
- magazinimi i artikujve industrialë, si solucionet larëse e pastruese duhet të bëhet në ambiente të veçanta,
- magazinimi i artikujve ushqimorë bëhet i ndarë sipas natyrës së tyre:

a) artikujt që nuk kërkojnë magazinim të ftohtë, si produkte të thata, pije të ndryshme, disa lloje zarzavatesh të freskëta etj.,

b) artikujt që kërkojnë ruajtje në temp. 2- 8 gradë, si produktet bulmetore, të mishit dhe peshkut të freskët, vezët etj.,

c) artikujt që kërkojnë ruajtje në temp. -10 gradë, si ushqimet e ngrira,

d) artikujt që kërkojnë ruajtje në temp. nën -10 gradë, si akullore etj.

I. Hotelet me “Një yll”

- kapaciteti pritës, jo më pak se 7 dhoma,
- recepsion i kompletuar me të gjitha pajisjet bashkëkohore,
- dhoma të kompletuara, mokat ose shendileta pranë krevatit,
- ngrohje e mjaftueshme në dhoma dhe në mjediset e brendshme,
- telefon/fax në dispozicion të klientelës,
- zyrë për administratorin ose për menaxherin,
- ashensor, kur godina ka mbi tre kate,
- holl sip. 16-25 m², me kënd pushimi komod me vende ulje sipas kapacitetit,

- sallë për ngrënien e mëngjesit, restorant,
- sistem komunikimi me sportelin për raste emergjence,
- televizor në holl ose në mjedise të përbashkëta,
- ofrimi i ndihmës së shpejtë.

II. Hotelet me “Dy yje”

Përfshijnë të gjitha kërkesat e hoteleve me “Një yll” plus:

- kapaciteti akomodues, min. 12 dhoma,
- sip. 30 m² deri 40 m²,
- bar dhe restorant të ndarë nga holli,
- televizor, minibar dhe telefon në çdo dhomë,
- parking për automjete, për min. 60 për qind të kapacitetit akomodues,
- dhomë ose depo për ruajtjen e bagazheve,
- ashensor, kur godina ka mbi tre kate,
- në çdo dhomë listën e çmimeve për shërbimet e ndryshme,
- shërbim në dhomë deri në orën 24.

III. Hotelet me “Tre yje”

Përfshijnë të gjitha kërkesat e hoteleve me “Dy yje” plus:

kapaciteti akomodues, min. 20 dhoma,
holl me sip. 50 m² deri 80 m²,
sipërfaqe minimale e dhomës:

- a) për një person krevat tek 12 m²
- b) për dy persona krevat dopio 14 m²
- c) për dy persona krevate teke 16 m²
- d) për tre persona krevate teke 14 m²

- telefon me lidhje interurbane,
- pasqyrë në përmasa minimumi 180 x 60 cm,
- bar me mjedis çlodhjeje,
- ajër i kondicionuar në të gjitha mjediset,
- dysHEMEJA e dhomës së gjumit, me moket ose me tapet i cilësi së lartë,
- restorant me menu,
- tavolinë pune në dhomë (skrivani),
- sistem alarmi automatik,
- sigurimin e ndihmës së shpejtë mjekësore,
- facilitete për pastrimin e këpucëve,
- sallë pritje për takime, për konferenca dhe të tjera evenimente,
- shërbime për larje dhe për hekurosje sipas kërkesave të klientelës,
- magazina për produkte dhe për pajisje,
- zyrë për këmbim valute,
- dyqan suveniresh,
- informacion në dhomë për shërbimet e ofruara,
- transport i bagazheve,
- mëngjesi i përfshirë në çmimin e fjetjes,
- kompjuterizim i mbajtjes së llogarive dhe rezervimit.

Banjot dhe tualetet

- sipërfaqja min. 3.5 m²
- vaskë
- bide
- stol
- tharëse flokësh
- kapuç dushi

IV. Hotelet me “Katër yje”

Përfshijnë të gjitha kërkesat për hotelet me “Tre yje” plus:

- kapaciteti akomodues, min. 50 dhoma,
- holl pritjeje me sip.min.120 m2 dhe kënde komode çlodhjeje,
- sipërfaqja minimale e dhomës:
 - a) për një person 14 m2
 - b) për dy persona 16 m2 (matrimoniale)
 - c) për dy persona 18 m2 (krevate teke)
- minimumi dy kolltukë në dhomë ose kënd pritjeje,
- radio dhe televizor,
- ashensor me sistem alarmi,
- depozitë për bagazhet e lidhur me ashensorin dhe shkallët e shërbimit,
- zyra të veçanta për drejtorin, për ekonomistët, për personelin e administratës,
- restorant të kategorisë së lartë që ofron gatim dhe nivel të lartë shërbimi, me vende uljeje në

raport me kapacitetin akomodues,

- snac-bar, aperitiv-bar, tarracë, tavernë, piano-bar etj.,
- lavanteri për larje, për hekurosje dhe për pastrim kimik,
- shtrimi i dysHEMEVE me materiale të cilësisë së lartë,
- shërbime argëtimi, mjedise dhe komplekse lojrash sportive (veçanërisht, për hotele në zona

bregdetare, klimatike-kuruese etj.),

- pishinë,
- shërbim në dhomë nonstop,
- në dhoma, qese plastike për rrobat e papastra,
- paketëzë për qepje,
- dhomë mjeku ose infermieri,
- parukeri (për burra dhe gra),
- minimumi një dyqan suvenir,
- sallë për konferenca, min. për 50 persona me sip 1.5 m2/ për person,
- telefon publik,
- duty-free shoop,
- informacion turistik.

Banjot

- sip.minimale 4 m2 dhe 100 për qind të pajisura me bide me ujë të nxehtë/të ftohtë,
- makinë rroje.

Masat kundër zjarrit

- sistem alarmi automatik i qëndrueshëm ndaj nxehtësisë dhe tymit,
 - shkallët e zjarrit,
 - shenjat dalluese treguese për drejtimin e kalimit kur fiken dritat,
 - pajisje për shuarjen e zjarrit (të paktën me lëndë kimike).

V. Hotelet me “Pesë yje”

Hotelet me “Pesë yje” i përkasin kategorisë së lartë të klasifikimit.

Kriteret, normativat dhe kërkesat e klasifikimit për këtë kategori janë të një shkalle shumë më të lartë.

Vendndodhja, zona e vendndodhjes, dimensionet dhe lloji i strukturës, cilësia dhe niveli i pajisjeve, dekorimi, gama e gjerë dhe niveli tepër i kualifikuar i shërbimeve të ofruara, përbëjnë kritere të rëndësishme për klasifikimin me “pesë yje”.

Klasifikimi i hoteleve me “pesë yje” përfshin kërkesat dhe normativat e klasifikimit me “katër yje” plus:

- porta e hyrjes kryesore detyrimisht dopio derë ose rrotulluese,
- holl i pritjes sip. min.160 m2 me shumë hapësirë ose min. 3 salla komunikuese,
- hyrje të veçanta për handikapë dhe për bagazhet,

- kapaciteti akomodues min. 100 dhoma,
- sipërfaqja minimale e dhomës:
 - a) për një person 16 m² (krevat tek)
 - b) për dy persona 18 m² (matrimoniale)
 - c) për dy persona 20 m² (krevate teke)
- apartamentet, jo më pak se tri ndarje, sipërfaqe minimale 60 m² (pa përfshirë banjat, tualetet, verandat),
 - 100 për qind e dhomave me izolim akustik dhe termik
 - mobilim cilësor dhe i larmishëm i dhomave, konforti në përputhje me standardet bashkëkohore dhe i një cilësie të lartë;
 - min. tre salla për koktej, për konferenca shtypi, për takime etj.,
 - sallë për kongrese, për konferenca, për mbledhje etj., me kapacitet jo më pak se 100 persona, me izolim akustik dhe me të gjitha pajisjet dhe aparaturat elektronike për përkthime dhe për bashkëbisedime,
 - kasafortë në dhomë për ruajtjen e sendeve me vlerë me kapacitet normal, e siguruar me dy çelësa dhe me sistem shifrash,
 - telefon me lidhje interurbane,
 - telefon i lidhur direkt me sallat e shërbimit,
 - sistem alarmi,
 - hekur hekurosje,
 - kartelë fosforishente “mos më shqetëso” për t’u varur në derën e jashtme,
 - pulsant për thirrjen e kamarierëve ose personelin e shërbimit,
 - komandim me pulsant ose i mekanizuar i tendave të errësimit,
 - televizor, sistem video, antenë me satelit,
 - garazh të hapur dhe të mbyllur me kapacitet 20 për qind të numrit të dhomave,
 - pishinë e hapur/e mbuluar, me sistem filtrimi, me kabina zhveshjeje, me dushe dhe me ndriçim të mjaftueshëm brenda e jashtë, ekip shpëtimi në gatishmëri të përhershme,
 - klub nate ose diskotekë,
 - kazino,
 - dhomë mjeku, mjek dhe infermier me shërbim non stop,
 - palestër me vegla gjimnastikore dhe aerobi,
 - sauna,
 - dhomë masazhi,
 - jo më pak se dy restorante të kategorisë së lartë me vende uljeje në raport me kapacitetin pritës, menu me ofertë edhe specialitete vendase,
 - sallë pastiçerie,
 - ashensor automatik për klientë, me material cilësor dhe dekoracion,
 - ashensor automatik i veçantë për handikapatë,
 - ashensor automatik për shërbimin,
 - tualete për handikapatë,
 - lavaneri, rrobaqepësi, dhomë për hekurosje dhe pastrim kimik,
 - në çdo dhomë, informacion hotelier dhe bllok të veçantë shënimesh,
 - kompleks dyqanesh, dyqan për shitjen e sendeve me vlerë, dhurata, parfumeri, gazeta, revista, kartolina etj.,
 - automjete në dispozicion për të garantuar transfertën e klientëve,
 - shërbim i stafit drejtues 24-orë.
- Materialet e servisit (pirunj, lugë, thika, pjata, gota sipas menuse dhe llojit të pijeve), mbulesat e tavolinës etj., duhet të jenë të një cilësie shumë të lartë dhe me emblemën e hotelit.
- Kompjuterizim i plotë i veprimeve dhe i proceseve me klientët (rezervim, llogari, pagesa etj.).
- Banjat dhe tualetet
 - sipërfaqja minimale 5 m²,
 - të shtruara me granit ose me mermer (material jorrëshqitës),

- vaskë me material të cilësisë së lartë, me përmasa 70x160x55 cm, rrethuar me armaturë, me mbështetëse tek koka dhe mbajtëse,

- perde ndarëse,
- pantofla me një përdorim,
- tapete për banjë,
- lavaman i vendosur në mur,
- bide,
- pasqyrë e madhe e ndriçuar dhe pasqyrë me zmadhim,
- etazher,
- sapun, shampo, qese higjienike, pambuk për pastrimin makiazhi dhe kapuç dushi cilësor,
- telefon dhe sistem alarmi i lidhur me recepsionin.

Masa kundër zjarrit

- në çdo dhomë, plani i katit për shkallët e zjarrit,
- sistem automatik për hapjen e dyerve, në rast evakuimi,
- shenja të veçanta drite të marra nga rrjeti elektrik,
- makineri dhe pajisje automatike për shuarjen e zjarrit,
- personel të specializuar për shuarjen e zjarrit.

Vendkalimi për handikapatët dhe për bagazhet me pjerrësi 6 për qind dhe gjerësi min.180 cm.

II. KRITERET E VLERËSIMIT DHE KLASIFIKIMIT TË MOTELEVE ME YJE

MOTEL – është njësia akomoduese turistike, me vendndodhje si rregull jashtë qendrave të banuara, në kryqëzime dhe afërsi të arterieve të mëdha të qarkullimit, e cila ofron, kryesisht për klientelë kalimtare, shërbimet e fjetjes, të ushqimit etj. dhe, detyrimisht të parkingut dhe të ndihmesës së parë mekanike.

Për t’u cilësuar “turistik”, moteli duhet të ketë një kapacitet prej min. 5 dhoma.

Ndihmesa e parë mekanike nënkupton: larje, vajtje, ndërrim gomash, furnizim me karburant dhe shërbime të tjera të emergjencës për mjetet e motorizuara.

Elemente të përgjithshme për vlerësimin dhe klasifikimin e moteleve:

A. Elemente të jashtme

1. Vendndodhja

- jashtë qendrave të banuara, në arterie dhe kryqëzime rrugore, përgjatë autostradave dhe rrugëve nacionale, në drejtim dhe me afërsi të qendrave turistike, historike, kulturore, sportive, porteve dhe aeroporteve.

Pamja e jashtme arkitektonike e strukturës

- në përshtatje me natyrën dhe me vendndodhjen e strukturës,
- strukturë e vetme ose disa struktura në afërsi me njëra-tjetrën dhe të përshkueshme me këmbë, por detyrimisht me një sanitare të veçanta.

3. Materiali i përdorur për ndërtim

- a) veshje me mermer, me granit, me material të veçantë,
- b) veshje me gurë të punuar, me tulla dekorative, me gurë dhe me dru natyror,
- c) suva plastike, suva e thjeshtë.

4. Parkingu

- me dy dyer për hyrjen dhe për daljen e lirshme të automjeteve,
- i hapur dhe i mbyllur në raport me kapacitetin e strukturës,
- i shtruar, i sistemuar dhe i siguruar me roje.

Mjedisi rrethues, niveli i higjienës, ndriçimi

- elemente dekorative, si pemë, lule, shatërvan, stola ose vende për të ndenjur etj.,
- i mirëmbajtur dhe me ndriçim të mjaftueshëm.

6. Kënde sportive dhe argëtuese, lodra për fëmijë

- në varësi të vendndodhjes dhe kapacitetit mund të ketë pishinë të hapur për të rritur dhe për fëmijë, kënde lojërash për fëmijë, kosha basketbolli, rrjeta voleybolli, fushë tenisi, minigolli etj.

7. Rruga për në motel

- e lidhur me rrugën kryesore, e shtruar dhe e niveluar, me gjerësi të mjaftueshme, min 4.5 m që garanton kalim të lirshëm të automjeteve.

8. Reklama, element shumë i rëndësishëm

- vendosur përgjatë rrugës, në një pozicion të dukshëm, në afërsi të strukturës, e dallueshme në distancë dhe e ndriçuar, për të tërhequr vëmendjen e automobilistëve,

- tabela të jetë e pajisur me shenjat orientuese për të lehtësur gjetjen e vendndodhjes së strukturës.

Struktura mundësisht e siguruar me roje 24 orë.

B. Elemente të brendshme

Recepsioni

- banak bashkëkohor i kompletuar,

- punonjës recepsioni,

- shërbimi i pronotimit,

- listë çmimesh dhe informacionesh për lloje të veçanta shërbimesh dhe llojet e taksave, nëse ka të tilla,

- informacion për kohë-qëndrimin e klientit dhe informacion turistik,

- mbajtje e çelësve,

- kasafortë për sendet me vlerë,

- me kërkesë, zgjimi i klientit në orarin e dëshiruar,

- kutinë e ndihmës së shpejtë,

- informacion për llojet e shërbimeve që ofrojnë dhe për oraret,

- afishimin e kursit të valutës dhe këmbim valute,

- telefon, faks etj.,

- hyrje e lirshme në çdo kohë për klientët e regjistruar.

Holli

- kënd çlodhjeje me sip. minimale 6 m², pa përfshirë recepsionin,

- dysheme e shtruar me pllaka, me mermer, me granit etj.,

- poltrona, tavolinë mesi,

- temperatura e ambienteve publike: normale,

- porta e hyrjes me përmasa që të lejojë hyrjen lirshëm të klientëve me bagazhet e tyre,

- i dekoruar me lule, me piktura etj.,

- televizor me ngjyra,

- mjedis i pastër dhe i mirëmbajtur,

- tualet (nyje sanitare) për klientët ndarë sipas sekseve.

Dhomat

100 për qind e dhomave me banjë.

Sipërfaqja minimale, pa përfshirë paradhomen dhe tualetin:

- dhomë me një krevat tek 9 m²

- dhomë matrimoniale 11 m²

- dhomë me dy krevate teke 12 m²

- lartësia e dhomës min. 260 cm

- paradhoma minimumi 1.4 m²

Temperatura e ambientit: normale.

Nuk lejohet ndërtimi i dhomave në katin përdhes të strukturës (me përjashtim të rasteve kur struktura ka distancë nga toka disa shkallë).

Pajisjet

- derë e sigurt me mbyllje nga brenda,

- krevat tek gjerësia min. 90 cm

- krevat dopio gjerësia min. 152 cm

- distanca midis krevatëve teke min. 50 cm

- distanca e krevatit nga dyshemja 55 cm

- komodinë dhe tavolinë,
- tualet me pasqyrë,
- karrige ose poltron,
- raft për rroba,
- mokat, tapet ose shendileta,
- perde të holla e të trasha ose grila për të mos depërtuar drita,
- abazhur tavani dhe komodinë.

Banjat

- sipërfaqja minimale 2,2 m²,
- temperatura e ambientit: normale,
- e shtruar dhe veshur me pllaka (mermer qeramikë etj.) mbi ½ e lartësisë së mureve, rezistente ndaj acideve e solucioneve dhe të pastrueshme me lehtësi,
- ajrosje natyrale ose aspirator,
- mbyllje e sigurt e derës nga brenda,
- dritaret të papërshkueshme nga shikimi i jashtëm,
- WC,
- lavaman,
- pasqyrë e ndriçuar mbi lavaman,
- etazher ose dollap,
- vaskë me perde ose kabinë dushi,
- mbajtëse peshqiri,
- mbajtëse letre higjienike,
- varëse për rroba,
- kosh për mbeturina,
- shampo, sapun etj.,
- rregullator voltazhi,
- ujë i ftohtë dhe i nxehtë i garantuar në çdo kohë,
- niveli i higjienës në lartësinë e duhur.

Dera e banjës duhet të hapet nga jashtë.

Pastrimi dhe rregullimi i dhomave çdo ditë.

Ndërrimi i biankerive për çdo klient të ri.

Dhomat e gjumit nuk duhet të korrespondojnë me ambientet publike, si holli, recepsioni, restoranti etj.

Ballkonet dhe verandat

- sipërfaqja min. jo më pak se 1.5 m²,
- lartësia e rrethimit jo më pak se 1 m,
- të mos korrespondojë me dhomën ngjitur,
- i kompletuar, në varësi të sipërfaqes dhe vendndodhjes,

Biankeritë

a. në dhoma në dispozicion të klientëve: çarçafë, këllëf jastëku, mbulesa krevati, batanije, jastëk rezervë,

b. në tualete në dispozicion të klientëve: peshqirë dushi ose mantobanje, peshqirë për fytyrë, peshqirë këmbësh, shendileta për banjë.

Korridoret

- gjerësia minimale 1.4 m,
- të ventiluara,
- me ndriçim të mjaftueshëm
- numrat e dhomave estetikë dhe të lexueshëm,
- pasqyra në çdo kat,
- skemën e evakuimit në rastet e rënies së zjarrit.

Shkallët

- shkallë për klientët,
- shkallët e emergjencës (në raste zjarri, tërmeti, uji etj.).

Ashensor (për godinë mbi tre kate)

- ashensor për klientët me sistem alarmi dhe kondicioner të brendshëm, gjerësia min. e dyerve 80

cm.

Sallë për ngrënien e mëngjesit

- e ndarë ose në një ambient me hollin,
- me vende ulje, në kapacitet me numrin shtretërve,
- e kompletuar me serviset përkatëse.

Sallë restoranti

- sipërfaqja min. 1 m² për person,
- temperaturë normale e ambientit,
- higjienë e lartë e ambienteve dhe e pajisjeve,
- kundërmimi i erërave të kuzhinës në sallë i palejueshëm,
- paraqitja estetike e menisë,
- llojshmëria e asortimenteve,
- shtrimi i tavolinave (molotone, mbulesa, sipërmbulesa, vazo lulesh, tavla cigaresh),
- cilësia e gatimit dhe paraqitja estetike e pjatës,
- dekorim i sallës dhe pajisje cilësore,
- perde, tavolina, karrige, mbajtëse çadrash etj.

Kuzhina

- mundësisht në të njëjtin kat me restorantin,
- përmasat në raport me kapacitetin e restorantit,
- mosdepërtim i tymrave, i erërave, i zhurmave etj., nga mjediset e kuzhinës në sallën e restorantit,
- pajisjet për gatim bashkëkohor dhe me standard të lartë,
- lavaman e lavapjata për larjen e enëve, të primeve etj.,
- aspirator,
- ujë i rrjedhshëm, i ftohtë dhe i nxehtë,
- ruajtje e produkteve ushqimore brenda normativave dhe kushteve higjieno-sanitare.

Furnizimi me ujë

- furnizim i pandërprerë me ujë të ngrohtë/ ftohtë me presion normal,
- rezervuar me kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar furnizimin me ujë, min. për dy ditë, në

raste të ndërprerjeve,

- detyrimisht përdorimi i ujit me parametra normale, (në rast ndotjeje eventuale, njoftim urgjent i klientelës).

Ndriçimi dhe izolimi elektrik

- i garantuar në vazhdimësi, me tension normal,
- sistem trefazor,
- çelës kontakti i pavarur në raste avarie,
- parametrat e ndriçimit të ambienteve në përputhje me funksionin,
- gjenerator pa zhurmë dhe me kapacitet të mjaftueshëm,
- instalimet elektrike dhe kutitë shpërndarëse të hidroizoluara sipas kushteve teknike, të

papërshkueshme nga uji/agentët atmosferik,

- të gjitha pajisjet elektrike detyrimisht të tokëzuara.

Masat kundër zjarrit

- struktura e ndërtuar larg burimeve të zjarrit,
- përdorimi i materialeve për ndërtim dhe arredim me koeficient të lartë rezistence kundër zjarrit,
- pajisjet e emergjencës për mbrojtjen kundër zjarrit,
- sistem alarmi në gatishmëri funksionimi,
- udhëzues për klientin për masat në rast rënie zjarri,
- planin e evakuimit në çdo kat dhe ambiente komune,

- rrufepritisë.

Sistemi i ventilimit

- i detyrueshëm në të gjitha mjediset, veçanërisht ato ndihmëse,
- natyral ose mekanik, por me fuqi aspiruese të mjaftueshme për të parandaluar erërat e huaja në mjediset e strukturës, si dhe për ajrin e ndotur të tualeteve në rast lidhjeje me të njëjtin oxhak ventilimi.

Magazinimi dhe ruajtja e artikujve ushqimorë dhe industrialë

- sipërfaqja e magazinës në vartësi të kapacitetit akomodues dhe të dimensioneve të strukturës,
- derë e sigurt brenda godinës,
- rafte dhe pajisje të tjera për ruajtjen në kushte optimale të artikujve,
- magazinim në ndarje të veçanta i artikujve industrialë (si solucione larëse, pastruese, etj.),
- magazinimi i artikujve ushqimorë, i ndarë sipas natyrës së tyre dhe në kushte normale.

Niveli i higjienës

- shumë i lartë në mjediset e brendshme të strukturës dhe në mjediset rrethuese,
- dezinfektimeve të pjesshme periodike dhe totale të mjediseve të strukturës,
- përzgjedhja e insekticideve dhe dezinfektimi me rekomandim të organeve kompetente dhe me procesverbal.

Personeli i shërbimit

- detyrimisht i pajisur me librezë shëndetësore,
- personel i përgatitur për kryerjen e shërbimit me profesionalizëm,
- shërbim me uniformë,
- paraqitja e jashtme e rregullt (higjiena personale, paraqitja etj.),
- garderojë dhe nyje sanitare të veçanta, parking i veçantë,
- formim profesional dhe njohje gjuhe të huaj (në vartësi të nivelit të klasifikimit dhe vendndodhjes së strukturës).

I. Motelet me “Një yll”

- kapaciteti pritës jo më pak se 5 dhoma,
- parking i hapur për automjete 100 për qind e kapacitetit të strukturës,
- asistencë mekanike për automjetet,
- furnizim me karburant,
- recepsion bashkëkohor,
- telefon, fax, etj. në dispozicion të klientëve,
- në holl kënd pushimi komod,
- sallë ose ambient i ngjashëm për ofrimin e mëngjesit,
- mëngjesi i përfshirë në çmimin e fjetjes,
- televizor në holl ose në një ambient të përbashkët,
- ofrim i ndihmës së shpejtë,
- dhomë e kompletuar sipas kërkesave të standardeve bashkëkohore,
- magazinë,
- ndërrimi i biankerive 1x3 ditë ose sipas kërkesave të klientit,
- rregullimi i dhomës dhe pastrimi i ambienteve çdo ditë.

II. Motelet me “Dy yje”

Përfshijnë të gjitha kërkesat e moteleve me “Një yll” plus:

- restorant të ndarë nga holli,
- depo për ruajtjen e bagazheve min. 4 m²,
- televizor në çdo dhomë,
- telefon i lidhur qoftë dhe me recepsionin,
- në çdo dhomë listën e shërbimeve me çmimet përkatëse,
- kondicioner ose sistem ngrohjeje në të gjitha ambientet,
- mëngjes i pakeluar për klientët që udhëtojnë herët,
- ndërrimi i biankerive 1 x 2 ditë,
- kënde lojërash për fëmijë dhe kënd sportiv.

III. Motelet me “Tre yje”

Përfshijnë të gjitha kërkesat e moteleve me “Dy yje” plus:

Kapaciteti akomodues min. 12 dhoma.

sipërfaqja min. e dhomës:

- a) me krevat tek 11 m²
- b) matrimoniale 12 m²
- c) me dy krevate teke 14 m²
- garazh i mbyllur 70 për qind të kapacitetit,
- sipërfaqja min. e hollit 12 m²,
- dopio derë ose derë rrotulluese,
- bagazhist,
- transport të bagazheve,
- depo për ruajtjen e bagazheve min. 8 m²,
- hyrje e veçantë për bagazhet,
- bar dhe restorant në dispozicion të klientelës,
- kënde lojrash për të rritur e për fëmijë,
- pishinë (në varësi të vendndodhjes),
- sallë për takime pune ose për konferenca,
- sallë për lojëra të qeta (shah, domino etj.),
- gardierobë,
- ballkon min. 2.5 m²,
- minibar,
- në çdo dhomë radiomagnetofon,
- lidhje telefonike interurbane në të gjitha ambientet,
- kabinë telefonike në holl,
- ndërrimi i biankerive çdo ditë,
- zyrë këmbim valute,
- dyqan për suvenire,
- dyqan shitjeje për artikuj të nevojshëm të domosdoshëm,
- sistem alarmi automatik në të gjitha mjediset,
- ofrohet shërbim larje dhe hekurosje, mundësisht pastrim kimik,
- zyrë për drejtorin,
- zyra për administratën,
- mjedise të brendshme të shtruara me mokete / tapete cilësore,
- mbajtëse për bagazhe në dhomë,
- tavolinë pune në dhomë,
- në çdo dhomë pasqyrë tualeti në tërë gjatësinë min. 180x60 cm,
- sistem alarmi në dhomë,
- në çdo dhomë kasafortë për ruajtjen e sendeve me vlerë,
- ofron shërbim në dhomë,
- facilitete për pastrimin e këpucëve,
- rezervimet dhe llogaritë të kompjuterizuara,
- personeli i shërbimit të klientelës, min. dy gjuhë të huaja.

Banjat

- sipërfaqja min. 3 m²,
- vaskë, bide, stol,
- tharëse flokësh, kapuç dushi,
- qese plastike për rrobat e papastra,
- sistem alarmi ose telefon portabël.

V E N D I M
Nr.281, datë 8.5.2003

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.646, DATË 12.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE TË PROJEKTIMIT
DHE TË ZBATIMIT NË FUSHAT E INDUSTRISË DHE TË ENERGJETIKËS, TË CILAT
DUHET TË MARRIN STATUSIN “RREGULLA TEKNIKE”, TË DETYRUESHME PËR
ZBATIM”“

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.646, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave, shtohen edhe standardet, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja

VAZHDIMI I LIDHJES NR.1 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.646, DATË
12.12.2002

Lista e standardeve të detyrueshme aktualisht në fuqi, që miratohen në “Rregulla teknike” të detyrueshme për zbatim.

I. Naftë, gaz dhe produkte naftë

23.S.Sh. 31: 1997lëndë djegëse për automjete me motora diezel gazoil (prodhim vendi)

IV. Produkte kimike

Emërtimi	Standard me kërkesat themelore
35. Acid nitrik teknik	STASH 1305-88 Përmbajtja e HNO ₃ në % Përmbajtja e metaleve të rënda në %
36. Acid sulfurik teknik	1305-88 Përmbajtja e H ₂ SO ₄ në % Përmbajtja e metaleve të rënda në % Përmbajtja e arsenikut në %
37. Acid klorhidrik teknik	1307-88 Përmbajtja e HCL në % Përmbajtja e metaleve të rënda në % Përmbajtja e arsenikut në %
38. Ujë amoniakal	1582-89 Përmbajtja e NH ₄ OH në % Përmbajtja e arsenikut në %
39. Karbonat natriumi teknik	1310-97 Vetëm përmbajtja e lëndëve të patretshme

40. Sodë kaustike teknike	1311-87 Përmbajtja e NaOH në % Përmbajtja e oksidit të hekurit
41. Sapun tualet	2162-88 Alkaliniteti i lirë në % Kloruret në %
42. Sapun rrobash	1513-87 Alkaliniteti i lirë në % Kloruret në %
43. Pluhur larës	1357-93 pH Përmbajtja e fosfateve në %
44. Tretësira për larje rrobash	2898-87 pH Përmbajtja e fosfateve në %
46. Sulfat bakri teknik	1374-88 Përmbajtja e plumbit në % Përmbajtja e arsenikut në %
47. Sulfat magnezi teknik	1312-87 Përmbajtja e lëndëve të patretshme në %
48. Bojë shkrimi	2273-87 Përmbajtja e lëndës së thatë në %
49. Qiri dhe parafinë	2166-88 Përcaktimi i pikës së shkrirjes
50. Shampo	3959-87 pH Densiteti
51. Pastë dhëmbësh	1639-87 pH Përmbajtja e kalciumit në %
52. Bojë vaji, bojë zmalto	916-87 Fuqia mbuluese
53. Bojë muresh	921-87 Përmbajtja e lëndëve të patretshme në ujë në %
54. Letër ofset	896-88 Përmbajtja e hirit në %
55. Letër gazete	895-88 Përmbajtja e hirit në %
56. Letër tipografike	2640-89 Përmbajtja e hirit në %
57. Letër shkrimi	894-88 Përmbajtja e hirit në %

V E N D I M
Nr.282, datë 8.5.2003

PËR HAPJEN E SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE, PRANË UNIVERSITETIT TË TIRANËS DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, paragrafi i 7, 24, 37 dhe 38 i ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e shkollave pasuniversitare (SHPU):
 - Në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, në degën:
 - Administrim publik.
 - Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës, në degën:
 - Inxhinieri elektrike, me drejtime:
 - automatizimi i industrisë;
 - elektroenergjetikë.
2. Tarifat e shkollimit për SHPU-të të jenë:
 - Për kandidatët nga stafi akademik, efektiv i shkollave të larta publike 75 000 lekë
 - Për kandidatët e tjerë nga sistemi buxhetor 100 000 lekë
 - Për kandidatët jobuxhetorë 150 000 lekë
3. SHPU-të administrojnë të ardhurat që mbledhin, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për mbulimin e shpenzimeve të tyre.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr.289, datë 24.4.2003**

PËR KRITERET DHE PËRBËRJEN E KËSHILLAVE MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME, SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8885, datë 22.4.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime, shtetërore të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, në sektorë strategjikë përbëhen nga 6 (gjashtë) anëtarë, kurse në shoqëritë e vogla dhe të mesme, nga 3 (tre) anëtarë.
2. Anëtarët e këtyre këshillave përzgjidhen si më poshtë vijon:
 - a) 2/3 e numrit nga kandidaturat e propozuara nga ministritë e linjës administrative ose organet e qeverisjes vendore;
 - b) 1/3 e numrit nga kandidaturat e propozuara nga Ministria e Ekonomisë.
3. Anëtarë të këshillave mbikëqyrës mund të emërohen punonjës të organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe punonjës të universiteteve e institucioneve kërkimore dhe shkencore, kur

legjislacioni nuk pengon pjesëmarrjen e tyre.

4. Kandidatët për anëtarë duhet të jenë diplomuar ose specializuar në degë të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Kandidatët për anëtarë në këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime, që veprojnë në sektorët strategjikë, të përfshirë në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, duhet të kenë përvojë pune jo më pak se pesë vjet. Ministri i Ekonomisë përcakton rregullat për verifikimin e dokumentacionit përkatës.

5. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës personat që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin, punonjës të organeve të qeverisjes qendrore ose vendore, që kryejnë funksione kontroll-revizioni, punonjës të drejtorive të shoqërive tregtare, drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare.

6. Ministri i Ekonomisë emëron anëtarët e këshillave mbikëqyrës në mbështetje të propozimeve të ministrive dhe organeve të qeverisjes vendore, në përputhje me raportet dhe kriteret e mësipërme.

7. Këshilli i Ministrave miraton përbërjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që veprojnë në sektorin strategjik, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë.

8. Këshilli mbikëqyrës zgjedh, në mbledhjen e tij të parë, kryetarin dhe nënkryetarin, të cilët propozohen nga Ministri i Ekonomisë. Kandidaturat për kryetar dhe nënkryetar të këshillave mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore, që veprojnë në sektorin strategjik, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, propozohen nga Kryeministri.

9. Këshillat mbikëqyrës i raportojnë ministrit të linjës administrative dhe Ministrit të Ekonomisë, me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtetëror, për ecurinë e zbatimit të programit të zhvillimit ekonomik dhe financiar, sa herë që e gjykojnë të nevojshme ose sa herë që kërkohet prej tyre, por jo më rrallë se një muaj pas mbylljes së çdo 3-mujori.

10. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në propozimet për këshillat mbikëqyrës të shoqërive të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të përdorura, bashkërendon punën me organet përkatëse të pushtetit vendor, për përfaqësimin e tyre.

11. Anëtarët e këshillave mbikëqyrës përfitojnë shpërblim mujor për veprimtarinë drejtuese të shoqërisë, që fillon nga mbledhja e parë, shpërblim, i cili përballohet nga shoqëria. Shpërblimi për kryetarin është 30 për qind, për nënkryetarin 25 për qind dhe për anëtarët e këshillit 20 për qind e pagës mujore të drejtorit të shoqërisë.

12. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të përfitojnë shpërblim vjetor në rastet kur realizohet fitimi i programuar dhe treguesit kryesorë, të përcaktuar në kontratën vjetore për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë anonime. Ky shpërblim nuk mund të tejkalojë vlerën e dy pagave mujore të drejtorit të shoqërisë dhe miratohet nga Ministri i Ekonomisë, pas mbylljes së llogarive vjetore.

13. Ndërsa për shoqëritë e dhëna tërësisht me qira ose enfiteozë, që nuk ushtrojnë veprimtari prodhuese, shpërblimi për kryetarin është 7 për qind, për nënkryetarin dhe për anëtarët 5 për qind të pagës mujore të drejtorit.

14. Vendimi nr.66, datë 24.2.2000 i Këshillit të Ministrave “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime, shtetërore”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

15. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, ministritë e linjës administrative dhe organet e qeverisjes vendore që, brenda 3 muajve nga miratimi i këtij vendimi, të rishikojnë përbërjen e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me kriteret e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lista e disa shoqërive anonime shtetërore që veprojnë në sektorët strategjikë

Nr	Emërtimi i shoqërive	Vendndodhja	Varësia administrative	% e kapitalit shtetëror	Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës	Vërejtje
1	ShA ANTA	Tiranë	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
2	ShA Albtransporti	Tiranë	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
3	ShA Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave	Durrës	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
4	ShA Autoriteti Portual	Durrës	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
5	ShA Telecom	Tiranë	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
6	ShA Posta Shqiptare	Tiranë	M.Transportit dhe Telekomunikacionit	100	6	
7	ShA Albpetrol	Fier	M.Industrië dhe Energjetikës	100	6	
8	ShA Armo	Fier	M.Industrië dhe Energjetikës	100	6	
9	ShA SERVCOM	Fier	M.Industrië dhe Energjetikës	100	6	
10	ShA KESH	Tiranë	M.Industrië dhe Energjetikës	100	6	
11	ShA Ujësjiellës Tiranë (qytet, fshat)	Tiranë	M.Reg.Territorit dhe Turizmit	100	6	

V E N D I M
Nr.292, datë 24.4.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.549, DATË 26.8.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat” dhe të nenit 54 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shtohen edhe tri tarifa të reja, me numër rendor 22, 23 dhe 24 sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME

22. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme në zonat urbane:	Ishte	Bëhet	(lekë)
- pa rilevim e azhurnim të pasurive nga zyrat e regjistrimit të pasurive;	-	3000	
- me rilevim dhe azhurnim të pasurisë nga zyrat e regjistrimit të pasurive.	-	6000	
23. Shërbime për veprimet e bankave dhe institucioneve të tjera kredidhënëse.			
- Për kredi në vlerë deri 1 000 000 lekë;	-	3000	
- Për kredi me vlerë nga 1 000 001 deri në 10 000 000 lekë;	-	6000	
- Për kredi me vlerë mbi 10 000 000 lekë.	-	10 000	
24. Regjistrimi mesatar i veçantë i pasurive të paluajtshme në zonat rurale.	-	30 000	

V E N D I M
Nr.295, datë 8.5.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS MESATARE TË
VLERËSIMIT VJETOR, INDIVIDUAL PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koeficientët për indeksimin e bazës mesatare të vlerësimit vjetor, individual, që personat e siguruar e kanë realizuar nëpërmjet pagimit të kontributeve, për efekt të llogaritjes fillestare të pensionit, sipas viteve, të jenë si më poshtë vijon:

Për vitin 20021

Për vitin 20011.14

Për vitin 20001.07

Për vitin 19991.09

Për vitin 19981.05

Për vitin 19971.22

Për vitin 19961.09

Për vitin 19951.37

Për vitin 19941.32

2. Efektet financiare, që lidhen në çastin e llogaritjes fillestare të pensioneve si rrjedhojë e

zbatimit të koeficientëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.258, datë 13.6.2002 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e bazës së vlerësimit vjetor, individual për llogaritjen fillestare të pensionit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.296, datë 8.5.2003

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË
PUNONJËSVE TË SHTETIT”“**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9 të nenit 1 e të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën që i bashkëlidhet vendimin nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin “Për grupin e dytë, shkronja “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, në paragrafin “dhe persona të tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë”, të shtohen emërtimet:

“Sekretar i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit;
Avokat i Shtetit në Avokaturën e Përgjithshme;
Drejtor i kabinetit të Zëvendëskryeministrit;
Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
Ndihmës i Presidentit;
Anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.”.

2. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të hiqet emërtimi “Këshilltar i Zëvendëskryeministrit” dhe të shtohen emërtimet “Shef kabineti i Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit” dhe “Avokat shteti pranë Gjykatës së Apelit, në zyrat vendore”.

3. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “c” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të shtohen emërtimet:

“Ndihmës i këshilltarit të Presidentit;
Zëvendëskryetar i këshillit të qarkut;
Jurist në Departamentin Juridik në Kryeministri.”.

4. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “d” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të shtohen emërtimet:

“Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë;
Sekretar i shefit të kabinetit në Presidencë;
Sekretar i këshilltarit të Presidentit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare që nga data e

derdhjes së kontributeve.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.297, datë 8.5.2003

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCESION, SI PROPOZIM I
PAKËRKUAR, SIPAS PROJEKTIT TË SHOQËRISË “LA PETROLIFERA ITALO RUMENA”
SPA PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E DEPOZITAVE BREGDETARE DHE TË
INFRASTRUKTURËS PORTUALE DETARE
NË GJIRIN E VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së dhënies me koncesion, si propozim i pakërkuar, sipas projektit të shoqërisë “La Petrolifera Italo Rumena” s.p.a. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave bregdetare të naftës e të nënprodukteve të saj dhe të infrastrukturës portuale detare në Gjirin e Vlorës, në zonën e miratuar si shesh ndërtimi me vendimin nr.9, datë 19.2.2003 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Miratimin e procedurave për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO”, (Ndërtim-Pronësi-Shfrytëzim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e depozitave bregdetare të naftës dhe të nënprodukteve të saj, sipas specifikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Miratimin e procedurave për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT”, (Ndërtim-Shfrytëzim-Transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale detare, në shërbim të depozitave bregdetare, sipas specifikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Organi shtetëror i autorizuar për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të koncesionit, që parashikohet në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, të jenë Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.299, datë 8.5.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.219, DATË 16.5.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E RACËS AUTOKTONE TË BUAJVE NGA
ZHĐUKJA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr. 7627, datë 21.10.1992 “Për shërbimin zooteknik” dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.219, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Pragu i gjendjes kritike për t’u zhdukur është 100 krerë riprodhues, të rritur, femra (buallica) dhe 8 krerë riprodhues, të rritur, meshkuj (bua)j”.
2. Në pikën 3, fjalët “... për vitin 2002.” zëvendësohen me “... për një periudhë 5- vjeçare deri në kalimin e pragut të gjendjes kritike për t’u zhdukur.”
3. Pika 4 ndyshon si më poshtë vijon:
“4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.”.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri më 31.12.2008.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.302, datë 15.5.2003

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-
HERCEGOVINËS, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë–Hercegovinës, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës, më tej referuar si Palët:

duke shprehur dëshirën e përbashkët për të zhvilluar më tej marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy shteteve;

duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre, ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e dy Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtën e hyrjes, daljes ose lëvizjes transit në territorin e vendit tjetër pa vizë.

Ata gëzojnë të drejtën e qëndrimit deri në 90 ditë nga momenti i mbërritjes.

Neni 2

1. Qytetarët e njërës prej Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të vlefshëm, të punësuar në misionet diplomatike ose konsullore dhe organizata ndërkombëtare, të akredituara në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të marrin lejen e qëndrimit nga vendi pritës pas hyrjes, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre. Në vazhdim të kryerjes së detyrimeve të tyre në misionet diplomatike ose konsullore dhe/ose organizatat ndërkombëtare, këta persona do të jenë të lirë të hyjnë dhe të dalin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Gjithashtu dispozitat e paragrafit të parë do të zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët bashkëjetojnë me ta në të njëjtin vend dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e qytetarëve të të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në territorin e vendit tjetër, duhet të bëhet nëpërmjet pikave kufitare zyrtare të të dy vendeve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk përjashton qytetarët e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Nga ana tjetër, kjo Marrëveshje i jep të drejtën çdo vendi të refuzojë hyrjen dhe/ose të ndalojë qëndrimin e qytetarëve të vendit tjetër në territorin e vet, nëse ato kryejnë veprime që thyejnë këto ligje dhe/ose rregulla.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk cenon ligjet dhe/ose rregullat me karakter të përgjithshëm në fuqi në të dy vendet në lidhje me sigurinë kombëtare, si dhe ato që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe lëvizjen e një qytetari të Palës tjetër, i cili mund të konsiderohet një person non grata.

Neni 6

Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi ndryshimin e këtyre specimeneve 30 ditë, përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi.

Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimenet e reja ose të ndryshuara të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duke përfshirë të dhëna lidhur me përdorimin e tyre para prezantimit të këtyre specimeneve.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të ngrihen në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë nga data e njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilës Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për pëmbushjen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar dhe do të jetë e vlefshme, deri sa njëra Palë njofton vendimin e saj për ta denoncuar nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet 30 ditë pasi Pala tjetër ka marrë njoftimin.

Kjo Marrëveshje mund të shtohet ose ndryshohet me pëlqimin e përbashkët të Palëve, nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike.

Bërë në Sarajevë, më 15 prill 2003 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

V E N D I M **Nr.304, datë 8.5.2003**

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMEVE DHE PËR DIETAT PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE DHE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE, KUR DALIN JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfitojnë shpenzime udhëtimi dhe dieta në valutë të huaj:

Punonjësit e ministrive, të institucioneve, ndërmarrjeve shtetërore etj., që dërgohen me shërbim si anëtarë delegacionesh për konferenca, veprimtari të ndryshme ndërkombëtare, bisedime për marrëveshje, biznes, anëtarë të ekipeve kulturore dhe sportive dhe punonjësit e përfaqësive tona jashtë shtetit, kur emërohen, transferohen, dërgohen me shërbim jashtë përfaqësisë ose në ndonjë shtet tjetër të huaj dhe kur kthehen në atdhe me shërbim ose kur transferohen.

2. Për efekt të llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve dhe dietave, personat ndahen sipas funksioneve, në tre kategori:

a) Në kategorinë e parë përfshihen personalitetet e larta shtetërore si: Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Nënkryetari i Kuvendit, ministrat dhe funksionarë të tjerë që barazohen në pagë me ta, deputetët, zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm të

ministrive dhe funksionarë të tjerë, që barazohen me ta në pagë.

b) Në kategorinë e dytë përfshihen: ambasadori, ministri fuqplotë i ngarkuari me punë në shtete të huaja, konsulli i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në ministri dhe institucionet e tjera qendrore dhe funksionet e tjera, që barazohen në paga me ta, si dhe punonjësit që kanë titullin shkencor “profesor”.

c) Në kategorinë e tretë përfshihen: të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive, institucioneve dhe përfaqësive, që nuk përmenden në shkronjat “a” dhe “b”.

3. Masa e dietave, sipas kategorive dhe funksioneve për çdo kategori, paraqitet në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë e pandarë e tij.

4. Shpenzimet e udhëtimit dhe dietat për vendet e kontinentit europian do të jenë në euro, ndërsa për vendet e kontinenteve të tjera do të jenë USD (dollarë amerikanë).

5. Kur shpenzimet janë në ngarkim të palës pritëse, si të qeverive të shteteve të ndryshme, të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat u sigurojnë personave, që përfitojnë dieta sipas këtij vendimi, vetëm shpenzimet e ushqimit dhe të fjetjes, pa u paguar asgjë në cash, atëherë këta persona përfitojnë nga buxheti i institucionit të tyre vetëm shpenzime të vogla (para xhepi), të përcaktuara në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë e pandarë e tij.

6. Kur shpenzimet janë në ngarkim të palës pritëse, që do të thotë se paguan tërësisht ose pjesërisht në cash dhe pjesërisht hotelin dhe restorantin, pavarësisht nga masa e dietës që paguan shteti ynë për këto raste, personat nuk përfitojnë asgjë nga buxheti i institucionit të tyre dhe nuk i detyrohen asgjë këtij institucioni.

7. Kur punonjësit e përfaqësive tona jashtë shtetit emërohen ose transferohen, marrin dietën e kategorisë përkatëse, ndërsa kur shoqërohen nga bashkëshortja/bashkëshorti, këta të fundit marrin dietën e kategorisë së tretë.

8. Shpenzimet e fjetjes dhe të udhëtimit për familjet e punonjësve të përfaqësive, që emërohen ose transferohen, përballohen nga shteti.

9. Me fondet e planifikuara për institucionet buxhetore, përveç shpenzimeve të transportit, vajtje jashtë shtetit e kthim, sipas urdhrat të drejtuesit të institucionit përkatës, të përballohen edhe shpenzimet e transportit brenda shtetit ku kryhet shërbimi, siç janë shpenzimet nga aeroporti në destinacion dhe anasjelltas, shpenzimet për lëvizjen nëpër qytete për nevoja pune, brenda shtetit përkatës, si dhe shpenzimet brenda qytetit ku kryhet shërbimi, për distanca të largëta, kur këto nuk vlerësohen si transport urban (për transportin urban shpenzimet përballohen nga vetë punonjësit).

10. Shpenzimet e fjetjes, të transportit dhe shpenzimet e tjera në ngarkim të shtetit, për të gjitha rastet, njihen sipas dokumentit përkatës (faturës, biletës etj.).

11. Pikat 14, 15, 16, 17, 19 dhe 20 të vendimit nr.473, datë 29.9.1993 të Këshillit të Ministrave dhe vendimet nr.463, datë 16.9.1993 e nr.48, datë 21.2.1994 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

12. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve të Jashtme të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1:

Për masën e dietave për jashtë shtetit konform pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave jashtë shtetit për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore”

Për kategorinë e I-rë

1.Presidenti i Republikës

2.Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit

3.Zëvendëskryeministri dhe Nënkryetari i Kuvendit ministrat, dhe

Në euro

Në doll U.S.A.

100

100

80

80

funksionarët e tjerë që barazohen me ta në pagë	70	70
4. Deputetët e Kuvendit dhe funksionarët e tjerë që barazohen me ta në pagë	60	60
5. Zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm të ministrive dhe institucioneve buxhetore dhe funksionarë të tjerë që barazohen me ta në pagë	50	50
Për kategorinë e II-të Ambasadorët, ministrat fuqiptotë të ngarkuarit me punë në shtetet e huaja, konsulli i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në ministri dhe institucionet e tjera buxhetore, punonjësit me titull shkencor “profesor” dhe të gjitha funksionet e tjera që barazohen me ta në pagë		40 40
Për kategorinë e III-të 1. Të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive dhe institucioneve buxhetore	35	35
Lidhja 2: Për masën e shpenzimeve të vogla për jashtë shtetit konformë pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave jashtë shtetit për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore”.	Në euro	Në doll U.S.A.
1. Kategoria e parë 40 për qind e dietës sipas lidhjes 1 për çdo funksion		
2. Kategoria e dytë Ambasadorët, ministrat fuqiptotë të ngarkuarit me punë në shtete të huaja, konsulli i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive në ministri dhe institucione të tjera buxhetore, punonjës me titull shkencor “profesor” dhe funksione të tjera që barazohen me ta në pagë	15	15
3. Kategoria e tretë Të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore, përfaqësive etj.	12	12

V E N D I M
Nr.306, datë 15.5.2003

PËR MIRATIMIN E AMENDAMENTIT NR.1 TË KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË DHE SHOQËRIVE OMV (ALBANIEN) ONSHORE EXPLORATION GMBH DHE HELENIC PETROLEUM SA PËR KËRKIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË BLLOQET 4 DHE 5 NË TOKËN SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e amendamentit nr.1 të kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së

Ekonomisë dhe të shoqërive OMV (Albanien) Onshore Exploration GmbH dhe Hellenic Petroleum s.a., për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqet 4 dhe 5 në tokën shqiptare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

AMENDAMENTI NR.1

I KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË BLOQET 4 DHE 5 NË TOKËN SHQIPTARE NDËRMJET MINISTRISË
SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
KOMBËTARE E HIDROKARBUREVE DHE OMV (ALBANIEN) ONSHORE EXPLORATION
GMBH DHE HELENIC PETROLEUM SA

Tiranë, më 29.8.2001

AMENDAMENTI NR.1

Amendament nr.1 është bërë dhe hyn në fuqi ndërmjet palëve në datën 29 gusht të vitit 2001 prej dhe ndërmjet:

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (referuar këtej e tutje si “Ministria”), e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (referuar këtej e tutje si “Akh”), një agjenci shtetërore e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

dhe

OMV (Albanien) Oshore Exploration GmbH, (referuar këtej e tutje si “OMV”), një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Austrisë, zyra e regjistrimit të të cilës ndodhet në Otto-Wanger-Platz 5, 1090 në Vienë, Austri,

dhe

Hellenic Petroleum s.a. (referuar këtej e tutje si “Hellenic”), një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Greqisë, zyra e regjistrimit të të cilës ndodhet në 54 Amalias Ave., GR-10558 Athinë, Greqi.

Kur konteksti i këtij amendamenti e kërkon, të dy, OMV dhe Hellenic, do të referohen kolektivisht si “Kontraktori” dhe të dy, AKH dhe Kontraktori, do të referohen kolektivisht si “Palët”.

SFONDI

Meqë, bazuar në “Ligjin për hidrokarburet” nr.7746, datë 28.7.1993, të amenduar me ligjin nr.8297, datë 4.3.1998, më 19 janar 1998, Ministria dhe Kontraktori kanë hyrë në një Marrëveshje me ndarje prodhimi (referuar këtu e më poshtë si P.S.C.) për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqe 4&5, çka është miratuar me vendimin nr.235 të 10 prillit 1998 e të amenduar me vendimin nr.395 të 24 qershorit 1998 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë;

meqë nëpërmjet vendimit nr.445 të 3 shtatorit 1993 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve përfaqëson Ministrinë në operacionet hidrokarbure në përputhje me ligjin dhe vetë P.S.C;

meqë, AKH-ja dhe Kontraktori dëshirojnë të amendojnë aneksin “A”- “Përshkrimi i zonës së kontratës” dhe aneksin “B”- “Harta e zonës së kontratës” të P.S.C. në përputhje me termat e saj,

atëherë, për rrjedhojë AKH-ja dhe kontraktori bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizimet

Termat e përdorua në këtë amendament do të kenë kuptimin që u është dhënë në P.S.C.

Neni 2
Aneksi “A”
Zona e kontratës

Nën titullin “Koordinatat gjeodezike të bllokut 5 në tokën shqiptare” janë shtuar edhe tri koordinata të reja menjëherë pas pikës 10.

11.400 25’ 54.28” N190 18’ 25.00” E

12.400 25’ 20.00” N190 21’ 36.00” E

13.400 25’ 20.00” N190 29’ 23.00” E

Në fund të paragrafit “Shpjegime”, nën të njëjtin titull “Koordinatat gjeodezike të bllokut 5 në tokën shqiptare”, është shtuar fjalëzimi i mëposhtëm:

“Linja tokësore midis pikave 11 dhe 12 dhe pikave 1 dhe 13 është përcaktuar si linja e bregdetit në lartësinë mesatare të ujërave midis baticës dhe zbaticës.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, e gjithë ajo pjesë e Gjirit të Vlorës që ndodhet në jug të vijës 12-13 (Aneksi “B”) dhe që kufizohet nga vija tokësore e Gjirit të Vlorës, është tashmë pjesë e zonës së kontratës”.

Neni 3
Aneksi “B”
Harta e zonës së kontratës

Si pasojë e koordinatave të reja të shtuara, siç jepet në nenin 2, harta e zonës së kontratës që përshkruan bllokun 5 në tokën shqiptare, është rivizatuar si bashkëlidhur këtij amendamenti.

Neni 4
Klauzola e përgjithshme

Të gjithë klauzolat e tjera të përcaktuara në P.S.C do të vazhdojnë të kenë fuqi dhe efekt të plotë.


Neni 5
Aprovimi i amendamentit të marrëveshjes

Kur aprovohet nga Këshilli i Ministrave, ky amendament do të jetë detyrues për Palët që prej datës efektive të kontratës. AKH-ja do të informojë Kontraktorin me shkrim mbi aprovimin e këtij amendamenti nr.1 brenda pesë (5) ditësh-pune pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave.

Si dëshmi këtui, amendament nr.1 është nënshkruar nga AKH-ja dhe Kontraktori në datën e përcaktuar së pari më lart.


Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve
OMV (Albanien) Onshore Exploration GmbH
Helenic Petroleum s.a.

HARTA E ZONES SE KONTRATES Blloku 5 ne Toke




ALBANIA

Licensed Exploration Areas



OFFSHORE ROUND

Licensed Blocks



V E N D I M
Nr.308, datë 8.5.2003

PËR DHËNIE EMRI AKADEMISË SË NËNOFICERËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Akademisë së Nënoficerëve t’i jepet emri “Lodewijk W.J.K.Tomson”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.309, datë 15.5.2003

PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË ALBKROMIT SHA, QË SHKURTOHEN NGA PRIVATIZIMI DHE DHËNIA ME KONCESION E INDUSTRIË SË KROMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albkrom” dhe të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve të administratës së Albkromit sh.a., të cilët shkurtohen gjatë vitit 2003, si rezultat i privatizimit dhe dhënies me koncesion të industrisë së kromit, t’u jepet një shpërblim, për dy vjet, i barabartë me pagën bazë mesatare mujore të vendit të punës që kanë marrë gjatë vitit 2002. Fondet e nevojshme të sigurohen nga të ardhurat që dalin nga privatizimi i objekteve të Albkromit sh.a.

2. Shpërblimin, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e përfitojnë punonjësit e Albkromit sh.a., të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune me këtë shoqëri për më shumë se një vit. Me fillimin e punës punonjësit i ndërpritet shpërblimi.

3. Ky shpërblim të bëhet me 8 këste, ku secili këst përfshin 3 muaj. Pagesa e shpërblimit fillon nga data e ndërprerjes së marrëdhënies të punës me Albkrom sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.312, datë 15.5.2003

PËR NDRYSHIMIN E VARËSISË SË KLUBIT SPORTIV SHUMËSPORTËSH “PARTIZANI” NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 29.1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 10 dhe 16 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh “Partizani” nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Objektet e këtij klubi, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, së bashku me mjetet përkatëse, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet fondi prej 21 500 000 (njëzet e një milionë e pesëqind mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të klubit sportiv shumësportësh “Partizani” fond, i cili t’i pakësohet buxhetit të vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Numrit të punonjësve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve t’i shtohen edhe 50 (pesëdhjetë) punonjës të klubit sportiv shumësportësh “Partizani”.

5. Vendimi nr.115, datë 16.2.1998 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv olimpiq “Partizani””, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E KOMPLEKSIT TË OBJEKTEVE TË KLUBIT SPORTIV SHUMËSPORTËSH “PARTIZANI”

1. Palestra e madhe (basketbolli, volejboli)
2. Palestra e gjimnastikës
3. Godina dykatëshe e sporteve të rënda dhe zyrat (salla e mundjes, ngritjes së peshave, mensa)
4. Godina dykatëshe (dhomat e zhveshjes së volejbollit e basketbollit)
5. Godina dykatëshe e atletikës
6. Godinat njëkatëshe (marangozi, çiklizmi, alpinizmi dhe depo e mensës)
7. Magazinat e materialeve sportive
8. Magazina e gazermimit dhe ish-palestra e mundjes për të rinj
9. Garazhi
10. Depoja e qymyrit
11. Pishina e notit, palestra e notit dhe zyrat në Laprakë
12. Palestra e atletikës (hangari)
13. Godina e tualetit (pranë magazinës së materialeve sportive)
14. Vendroja (godina e informacionit)
15. Fusha e tenisit dhe volejbollit në hyrje të klubit, djathtas
16. Fusha e basketbollit dhe hendbollit (5 të tilla në hyrje të klubit, majtas)
17. Dy fusha volejboli të reja pranë godinës dykatëshe të lojërave

18. Gabinë elektrike
19. Sheshi para godinës dykatëshe (përdoret për parkim makinash)

U R D H Ë R
Nr.54, datë 8.4.2003

**PËR HARTIMIN, MIRATIMIN DHE NDJEKJEN E PLANIT TË VEPRIMIT “PËR
MENAXHIMIN E SEZONIT TURISTIK VEROR 2003”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës,

U R D H Ë R O J:

1. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, brenda datës 15.4.2003 të miratojë planin e veprimit “Për menaxhimin e sezonit turistik veror 2003”.

2. Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave, në bashkëpunim edhe me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, të marrin masat ligjore e teknike, për lehtësimin e procedurave të hyrje-daljes të shtetasve të huaj në pikat e kalimit kufitar dhe për lejimin e hyrjes së turistëve të huaj, pa vizë, gjatë sezonit turistik veror, sipas vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave me ndryshimet përkatëse.

3. Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Shtetëror të marrin masat për sigurimin e rendit, zbatimin e etikës profesionale të Policisë së Shtetit dhe, në mënyrë të veçantë, për rritjen e sigurisë në akset kryesore rrugore dhe në zonat turistike.

4. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të organizojnë punën për përmirësimin, sigurimin dhe shtimin e sinjalistikës rrugore në akset kryesore kombëtare dhe, në mënyrë të veçantë, në zonat turistike.

5. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik, të marrë, për periudhën 1.6.2003 deri më 30.9.2003, brenda datës 10 të muajit pasardhës, të dhëna mujore për hyrje-daljet në pikat kufitare.

6. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe me organet e qeverisjes vendore, të vendosë tabela promocionale në pikat e hyrje-daljes dhe në qendrat e qyteteve.

7. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të marrë të gjitha masat për licencimin e subjekteve, që merren me veprimtari turistike (si hoteleri, agjenci turistike, udhëtimesh, transport turistik), si dhe të bëjë regjistrimin dhe klasifikimin e njësive pritëse turistike.

8. Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave të marrin masa për mbledhjen e tatim-fitimit të planifikuar mbi baza reale nga të gjitha subjektet turistike, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për licencimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike.

9. Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin masa përkatëse për mbështetjen financiare dhe kryerjen e procedurave administrative të nevojshme, në kuadër të planit të veprimit “Për menaxhimin e sezonit turistik veror 2003”, për lehtësimin dhe thjeshtëzimin e procedurave doganore në pikat kufitare për shtetasit e vendeve fqinje, me kombësi shqiptare (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi).

10. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të organizojë veprimtari të përbashkëta për hapjen e sezonit turistik dhe veprimtari të tjera kulturore e argëtuese, në bazë të kalendarit të veprimtarive kulturore të planifikuara.

11. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të organizojë punën për rifreskimin e vazhdueshëm të materialeve promocionale (guidave, fletëpalosjeve, posterave etj.).

12. Me nismën e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të Ministrisë së Pushtetit

Vendor dhe Decentralizimit, të Ministrisë së Mbrojtjes, si edhe në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të merren masa për pastrimin e plazheve dhe të mjediseve përreth tyre, për heqjen e mbetjeve inerte dhe të hedhurinave të ndryshme, sidomos në plazhet e Durrësit, të Golemit, Vlorës, Sarandës, Pogradecit, Himarës dhe Shëngjinit.

13. Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe prefekturat e qarqeve në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të marrin masa për organizimin e shërbimit të pastrimit të përditshëm të plazheve dhe të shërbimeve komunale, të shërbimeve për sigurimin e ndihmës së shpejtë mjekësore dhe për ofrimin e shërbimit zjarrfikës.

14. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të marrë masat përgatitore për sigurimin e shërbimit telefonik, për përfundimin e punimeve për shtrimin, sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve kombëtare dhe vendore në zonat turistike.

15. Të gjitha ministritë dhe institucionet e përmendura në këtë urdhër të njoftojnë rregullisht, çdo 15 ditë, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit për masat e marra dhe detyrat e kryera.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

U D H Ë Z I M

MBI LICENCIMIN DHE KONTROLLIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË TURISTIKE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me ndryshimet përkatëse dhe të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 “Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarisë turistike” dhe nr.518, datë 12.8.1996, pika 3 “Për kategorizimin, regjistrimin dhe klasifikimin e njësive akomoduese”,

U D H Ë Z O J M Ë :

1. Organet tatimore nuk do të regjistrojnë dhe nuk do të lejojnë asnjë subjekt të njohur me vendim gjykatë si person juridik ose fizik për ushtrim veprimtarie turistike si “agjenci turistike udhëtimi”, “veprimtari turistike akomoduese” (hoteliere) dhe “transport turistik për udhëtarë”, nëse ai nuk është i pajisur paraprakisht me licencën përkatëse të lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

2. Subjektet e lartpërmendura, të palicencuara, por të regjistruara në organet tatimore përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, janë të detyruara të paraqesin në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit kërkesën e tyre për pajisje me licencë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të vërë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave:

a) listën e subjekteve të licencuara prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ushtrimin e veprimtarisë turistike përkatëse;

b) listën e subjekteve të evidentuara dhe të identifikuara me ushtrim veprimtarie turistike, por të palicencuara prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit;

c) listën e njësive akomoduese turistike të paregjistruara në regjistrin e njësive akomoduese turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të papajisura me certifikatën e klasifikimit të njësive akomoduese turistike, të lëshuar prej saj.

4. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, të përditësojë rregullisht listat e mësipërme dhe, çdo 3 muaj, t'ia dërgojë ato, me sqarimet e nevojshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave.

5. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave të bashkëpunojnë për informimin e subjekteve mbi detyrimin e tyre ligjor për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë turistike, si dhe për rritjen e shkallës së njohjes prej tyre të akteve normative dhe rregulloreve përkatëse në fuqi, nëpërmjet mediave dhe aktiviteteve të përbashkëta të organizuara në bashki ose qarqe me zhvillim turistik.

6. Drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave (nëpërmjet strukturave të policisë tatimore) të bashkëpunojnë për të zbatuar, ndaj subjekteve me ushtrim veprimtarie turistike të papajisur me licencën përkatëse të lëshuar prej Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, sanksionet administrative sipas dispozitave në fuqi, deri në ndërprerjen ose mbylljen e ushtrimit të veprimtarisë së tyre turistike.

7. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave dhe drejtoria, e cila mbulon veprimtarinë turistike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
BESNIK DERVISHI

MINISTRI
KASTRIOT ISLAMI

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 30.5.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë